


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIQUE DU KOSOVO
REPUBLICA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar me Primljen:	10 - 12 20 24	
Njësie Jednica	Numri Broj	Shtet, qytet Dodataku
15-016/61+60860		

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DATË/A:	10.12.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Daut Azemi- Kryesues i Kuvendit te Komunës Lipjan Antarëve të kuvendit Komunal-Lipjan
CC:	Arkivit
NGA/OD/FROM:	Fjolla Ibrahimimi Starabaja- Kryesuese e këshillit në mbrojtje të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore për Komunën e Lipjan. 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë e Këshillit Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimate të dhunës në baza gjinore.

Inderuar,

Përmes kësaj shkrese do të merrni informatë rrëth punës së Këshillit Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimate të dhunës në baza gjinore për Komunën e Lipjanit që nga themelimi i saj. Andaj, kërkojmë që në seancën e radhës të jetë pikë e rendit të ditës edhe informata e Këshillit Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimate të dhunës në baza gjinore.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DATË/A:	09.12.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Imri Ahmeti- Kryetar i Komunës – Lipjan Daut Azemi- Kryesues i Kuvendit te Komunës Lipjan Antarëve të kuvendit Komunal-Lipjan
CC:	Arkivit
NGA/OD/FROM:	Fjolla Ibrahimim Starabaja- Kryesuese e këshillit në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore për Komunën e Lipjan.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informatë e Këshillit Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore.

Inderuar,

Përmes kësaj shkrese do të merrni informatë rrëth punës së Këshillit Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore për Komunën e Lipjanit që nga themelimi i saj.

Ky raport përban materiale konfidenciale. Dorëzimi i këtij rapporti te ndonjë person tjetër përveç marrësëve të synuar nuk heq dorë në asnjë mënyrë nga konfidencialiteti.

Përdorimi, zbulimi ose kopjimi i paautorizuar është rreptësishtë i ndaluar. Andaj duhet të veprohet konformë bazës Ligjore, dhe njëkohësisht të mirret në konsideratë çdo informacion i dhënë në kuadër të këtij Këshilli dhe çdo lloj aktiviteti i paraqitur në këtë raport kronologjik ndër vite.

Përbledhje ekzekutive

Dhuna në familje është vepër penale¹ dhe fenomen që lëkund vlerat e shoqërisë demokratike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës² në kuadër të parimeve të saj, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke i konsideruar ato si të pandashme, të patjetërsueshme e të pacuneshme.

Me qëllim të parandalimit dhe ngritjes së efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, duke synuar plotësimin e standardeve për ofrimin e mbrojtjes së duhur viktimate të dhunës në familje, në pajtim me Konventën e Stambollit, është hartuar Ligji për Mbrojtje nga dhuna në familje, që “dhunën në familje”³ e përkufizon: “veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezulton me abuzim, kur kryhet nga një person që është apo ka qenë në marrëdhënie familjare me viktimin”.

Duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga korniza ligjore dhe standardec ndërkombëtare, mbështetur në masë të gjerë në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje/politikat nacionale dhe Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (2022 – 2025), që njëherit paraqet një vazhdimësi logjike të përkushtimit të institucioneve qeveritare për një zgjidhje funksionale dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje dhe eliminimin e pabarazive e shtrirë në nivel lokal, Kuvendi Komunal Lipjan nën koordinimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, me përkrahjen e OSBE në Kosovë për komunen e Lipjanit është duke hartuar “Strategjinë Komunale dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje”.

Duke dënuar të gjitha format⁴ e dhunës në familje dhe bazuar në jetësimin e parimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara “Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë”⁵, strategjia është e

¹ Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 248;

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli II;

³ Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 2.1(1.1): E definon si të tillë mes personave që janë/kanë qenë: të fejuar, të martuar; në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët, si dhe përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martese, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë, janë prindër të një fëmije të përbashkët, janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëni familjare: <http://eeë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf> 2;

⁴ Dhuna në familje, dhuna fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike, për nevojat e kësaj strategjie do të jetë e njëjtë siç është përkufizuar ne dispozitën e nenit 2, nën paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;

⁵ OKB, Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 1, 1945;

përqendruar në fuqizimin dhe funksionalizimin e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në përputhje me përgjegjësitë e tyre të përcaktuara në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, kornizës ligjore në fuqi dhe obligimeve që rrjedhin nga Konventa e Stambollit për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, duke synuar rritjen e koordinimit efektiv dhe bashkërendimin e veprimeve në minimizimin e fenomenit të dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimës së dhunës.

Përbërja- Këshilli komunal koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore, është në përbërje prej 39 antarëve si vijon:

Antarë nga kabineti i zyrës së Kryetarit, Drejtorati për shëndësi dhe përkujdesje sociale, Qendra për punë sociale, QKMF, Emergjencia, Zyrtari për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, Sektori për Arsim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Policia-njesia e hetuesisë- Lipjan, Policia e komunitetit- Lipjan, Zyra Rajonale e Punës, Prokuroria- Mbrojtësi i viktimave të dhunës-Departamenti i Mbrojtjes së Viktimave, Strehimorja QMGF, Zyra Lokale për Komunitete, Drejtorati për Inspepcion, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Grupi i Grave në Komunën e Lipjanit, Asambleiste, Kryqi i Kuq i Kosovës-Lipjan, GJTHP-Dega Lipjan, Drejtorati për Administratë, BIK i Bashkësisë Islame –Departamenti i gruas, QEKL-Qendrës Korrektuese edukuese për gra dhe të mitur, Shërbime juridike falas, OJQ The Ideas Partner Ship, Ojq Women's Alliance for Integration(WAI), zëdhënësia e Komunës, Psikologe nga shkolla, OJQ Handikos si dhe nga Shoqëria Civile.

Vlen të ceket se secili antarë është përzgjedhur nga institucioni ku punon zyrtari/ia.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit

Këshilli ka për detyrë që të raportoj të dhënrat në rasteve të dhunës, të krijoj një data bazë me të gjitha të dhënrat mbi viktimat, të ndara në bazë të llojit të dhunës, moshës, statusit dhe shënime tjera, të avokon dhe lobon në institucione dhe të shoqëria civile për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, të shkëmbet përvoja lidhur me ndihmën, të fuqizoj bashkëpunimin në mes partnerëve si dhe të mbroj dhe promovoj të drejtat e viktimave.

Misioni

Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare, mbrojtje dhe rehabilitim për vikmat e dhunës në familje, promovim të mirëqenies sociale të barabartë pavarësisht etnitetit, bindjet fetare, orientimeve tjera dhe strukturës shoqërore; - Definim i prioriteteve strategjike për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje; - Krijim i një kulture gjërësishtë të pranuar për njohjen dhe parandalimin e dhunës në familje nëpërmjet rritjes së kuptimit të të drejtave themelore të njeriut; - Zhvillim i qasjes gjithëpërfshirëse në realizimin e detyrave të parapara me plan në kuadër të strategjisë lokale të KKMVDHFBGJ.

Vizioni

Zhvillim i një sistemi gjithëpërfshirës dhe efektiv për parandalim të dhunës në familje në komunën e Lipjanit. Përpilimi i dokumentit strategjik për mbrojtje nga dhuna në familje, dhe zërthyer në plan periodik e vjetor me qëllim të kuptuarit e dhunës në familje si shkelje serioze e të drejtave të njeriut dhe të ngritet vetëdija publike për mostolerimin e dhunës në familje; - Rritje e sigurisë së viktimate; - Rritje e numrit të aktiviteteve për hetime efikase, ndjekje penale dhe përgjegjësi; - Rritje të cilësisë së shërbimeve për vikmat dhe standardizim të tyre; - Rritje e efektivitetit të sistemit nëpërmjet planifikimit strukturor, monitorimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit të situatave.

Prioritetet:

1. Rritja e mirëqenies sociale përmes ngritisë së cilësisë së shërbimeve sociale, dhe ofrim të mundësive të barabarta për mbështetje dhe promovim të mirëqenies në baza gjinore
2. Fuqizimi i rolit të partneritetit ndër-institucional, dhe publiko-privat – ofruesëve të licensuar për shërbime sociale.
3. Zbutja e varfërisë përmes programeve mbështetëse investitive për gra, burra në nevojë e sidomos në grupet e cenueshme
4. Sundim i ligjit, dhe zhvillim i kapaciteteve të barabarta njerëzore pavarësishtë bazave gjinore, seksit, orientimeve tjera.

REFLEKTIM

Komuna e Lipjanit është Komuna e parë në rajonin e Prishtinës që e ka themeluar Këshillin përmbrojtje të viktimateve të dhunës në familje dhe baza gjinore.

KKMVDHFBGJ ka filluar punën me vendim të Kryetarit në shkurt të vitit 2016, inicuar kërkesa nga Drejtoresha e Qendrës për Punë Sociale, Makfirete Shamolli, pas takimit të organizuar më 18.12.2016 nga OSBE, për themelimin e KKMVDHFBGJ.

Më 10.07.2018 kryesuesja e këtij këshilli ka dhënë dorëheqje me kërkesën që të lirohet nga detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit dhe më pas me propozim dhe me vota unanime nga ky Këshill është propozuar dhe zgjedhur si kryesuese e këtij Këshilli, Fjolla Ibrahim Starabaja nga QPS-Lipjan.

Këshilli KMVDHFBGJ sipas plan-programit të miratuar në kuadër të Këshillit raporton përmillimet, aktivitetet, vështirësitë, problemet, dhe të arriturat e këshillit, andaj edhe sipas këtij protokolli të këshillit, i reportohet zyrës së Kryetarit cdo viti.

Ky rapport ka shërbyer në mbajtje të kontinuitetit rrith praktikës së raportimit dhe informimit dhe në reflektim të një pasqyre sa më e qartë për orientim të shërbimeve në kuadër të preventivës dhe parandalimit përviktimat të dhunës në baza gjinore dhe familjare.

Raporti është hartuar dhe punuar duke u bazuar në realizimin e objektivave në kuadër të planit strategjik, dhe në kuadër të takimeve dhe zhvillimeve në programin e punës sipas detyrave të këshillit brenda që nga viti 2016 deri më tani 2024.

Ky rapport do të paraqesë punën disa vjeqare në kuadër të këshillit komunal për KKMVDHFBGJ, e cila përbajtje do të jetë në funksion të orientimit të shërbimeve dhe në kuadër të politikës sociale në përfaqësim të grupeve të cenueshme dhe në nevojë relative përmes mbështetje sociale në familje dhe baza gjinore.

Aktivitete nga viti 2016-2024:

Këshilli Komunal në mbrojtje të viktimate të dhunës në baza gjinore dhe familje ka mbajtur takimet e rregullta dhe njëkohesishtë ka hartuar planin afat shkurtër strategjik në mbrojtje të KKMVDHBGJ, i cili plan ka pasuar me 6-të objektiva të qarta në fuqizim të kapaciteteve ndërinstitucionale dhe në kuadër të avokimit dhe ofrimit të shërbimeve për Viktimat e dhunës në baza gjinore dhe familjare, njëkohesishtë ka adresuar rekomandime propozime e kërkesa për ti mbeshtetur viktimat e dhunës gjatë procesit të ri-integrimit dhe rehabilitimit në kuadër të Ekzekutivit Komunal.

Vlenë të theksohet: Këshilli për mbrojtje të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore ka shenuar aktivitet ndër vite siç vijon:

Viti 2016

*Më 25.11.2016 është lansuar fushata 16- ditët e aktivizimit stop! Dhunës ndaj Gruas përmes mediumit KTV, RTV-21, Portaleve: Ulpiana press, Lipjani info, Lipjani News. Si dhe në kuadër të Gazetës " Koha Ditore" etj.

*Marshim në qytetin e Lipjanit dhe shpërndarja e broshurave vetëdijesuese për dhunën në familje në sheshin "Adem Jashari"-Lipjan, aktivitet shpërndarja e luleve-250 trëndafila të bashkangjitura në çdo trëndafil nga një mesazh me temën kundër dhunës në familje.

Nisja nga Komuna për në Sheshin Adem Jashari-Lipjan.

* Më dt. 13.07.2016 është mbajtur trajnimi "Fuqizimi dhe promovimi i riintegrimit për viktimat e dhunës në familje dhe asaj në baza gjinore në Komunën e Lipjanit- Organziuar nga Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me Ojq "Operacioni i Mëkëmbjes" ku edhe janë certifikuar zyrtarët e këshillit Komunal VDHFBGJ.

VITI 2017

*Ngitja e vedijës së komunitetit dhe në fuqizimin e gruas përmes takimit vedijësues me rastin e ditës ndërkobëtare për të drejtat e gruas më 8 mars 2017. Mirënjohje për grata/ nënata që sakrifikuani dhe krijuani lidershipin e Komunës së Lipjanit.

*Mbështetje në PSV (procedurave standard të veprimit) në kuadër të akterëve ndër-institucional.

*Mbajtja e takimeve publike në preventivë dhe parandalim të dhunës në familje dhe baza gjinore në kuadër të ndërgjegjësimit dhe vedijësimit se dhuna në baza gjinore paraqet shkelje serioze në kuadër të të drejtave të njeriut, dhe se dhuna ndaj gruas paraqet shkelje në kuadër të të drejtave të njeriut.

*Spot në tv qendrore, lansimi i fushatës 16 ditët e aktivizimit – stop dhunës ndaj gruas, në spot morrën pjesë antarët e KKMVDHFBGJ- Lipjan.

*Takimet të mbajtura më: 06, 07.12.2017 në bashkësinë lokale në Janjevë me gratë, shpërndarja e broshurave vetëdijesuese për dhunën në familje.

*Takimi i datës 06,07.12.2017 është realizuar me përfaqësues me nxënësve të shkollës në fsh. Janjevë organizuar nga OSBE me antarët e KKMVDHFBGJ.

*Pjesmarrje publike e antarëve të këshillit: Makfirete Shamolli, Fjolla Ibrahim Starabajadhe Afërdita Gashi në solidarizim të 16- ditorit me viktimat e dhunës në familje në mediumin KTV, RTV-21 më 05,06.12.2017.

Viti 2018

* Marsh se bashku me Ekzekutivin Komunal përfshirë edhe Kryetarin e Komunës, nënkyetarin e Komuës si dhe akterët bashkëpunues, mbajtja e takimeve publike në preventivë dhe parandalim të dhunës në familje dhe baza gjinore në kuadër të ndërgjegjësimit dhe vetëdijësimit, mbajtur në çdo viti të 16 ditorit kundër dhunës në familje po ashtu gjatë kësaj dite ka pasur edhe aktivitet në shpërndarje të broshurave për ndërgjegjësim dhe vedijësim lidhur me 16-të ditorin e aktivizimit "stop dhunën ndaj Gruas!. Në sheshin "Adem Jashari"-Lipjan.

*Dekorimi i sallës së Kuvendit në Komunën e Lipjanit me fjongo, si dhe për të gjithë asambleistët dhënia e broshurave të dhunës në familje si dhe udhëzues për dhunën në familje të siguruar nga zyra për barazi gjinore.

* Takim me nxënësit e shkollës së mesme Gjimnazi "Ulpiana", ku është prezentuar shfaqja teatrale me temën "Më dëgjo mua" nga nxënësit e shkollës "Ibrahim Banushi" si dhe eksposita e pikturnave nga nxënësit e shkollave "Ulpiana dhe Adem Gllavica".

*Takim me nxënësit e shkollës së mesme "Adem Gllavica", ku është prezentuar shfaqja teatrale me tëmen "Më dëgjo mua" nga nxënësit e shkollës "Ibrahim Banushi" si dhe eksposita e pikturnave nga nxënësit e shkollave "Ulpiana dhe Adem Gllavica".

*Tryezë debati me rini (Organizuar nga Youth Center Lipjan & USAID dhe ATRC).

*Shfaqja teatrale nga nxënësit me temën "Më dëgjo mua" nga nxënësit e shkollës "Ibrahim Banushi" si dhe eksposita e pikturnave nga nxënësit e shkollave "Ulpiana dhe Adem Gllavica". për dhunën në familje në shtëpinë e kulturës- Kinemaja "ABC" Lipjan, koktell nga ora 12 në restaurant "Centrum " Lipjan , ku pjesëmarrës ishin 700 persona.

Viti 2019

Ne vitin 2019, Këshilli me përkrahjen e OSBE- zhvilloi disa aktivitete per te shenuar 16 ditët e aktivizmit, sic janë, tryezë diskutimi me anetarët e këshillit se si institucionet e mekanizmat e ndryshëm i qasen dukurisë së dhunës në familje, cili është niveli i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të mekanizmave lokal në trajtimin dhe menaxhimin e rasteve te dhunës në familje.
Pra, përmes këtij diskutimi është synuar thellimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit të akterëve lokal në ofrim të shërbimeve sa më kualitative për viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore. Kjo mbeshtetje nga OSBE vazhdoi edhe me aktivitete/sesione këshilluese me nxënësit e shkollave të mesme në Lipjan dhe nxënësit e shkollës në fsh. Janjevë si dhe shfaqja teatrale nga nxenësit e shkollës së Shalës siç vijon:

* Marsh se bashku me Ekzekutivin Komunal përfshirë edhe Kryetarin e Komunës, nënkyetarin e Komunës, antarët e KKVDHFBGJ si dhe akterët bashkëpunues duke përfshirë asambleistët.

*Shfaqja e filmit „Nuk është prona jote”– Organizuar nga OKB dhe zyra për barazi gjinore. Filmi është shfaqur në Sallën e Kuvendit në Lipjan.

*Tryezë e rrumbullakët nga akterët e këshillit me temën “Dhuna në familje” si dhe shfaqja teatrale në shkollën filliore“Ibrahim Banushi” në fsh.Shalë.

*Tryezë e rrumbullakët nga akterët e këshillit me temën “Dhuna në familje” si dhe shfaqja teatrale në shkollën filliore “Shtjefën Gjeçovi” në fsh.Janjevë.

*Tryezë e rrumbullakët nga akterët e këshillit me temën “Dhuna në familje” si dhe shfaqja teatrale në shkollën e mesme “Adem Gllavica” në Lipjan.

*Tryezë e rrumbullakët nga akterët e këshillit me temën “Dhuna në familje” si dhe shfaqja teatrale në shkollën e mesme “Ulpiana” në Lipjan.

Viti 2020

*Gjatë pandemisë COVID19, bazuar në nevojën dhe kërkesën për prezencë të Punëtorit Social në Qendrën e studentëve –Prishtinë- Karantinë për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje që fillimishtë ku viktimat janë detyruar të karantinohen dhe pastaj të vazhdojnë në proceset tjera, është përfaqësuar nga zyrtari i shërbimeve sociale- Fjolla Ibrahimini- kujdestari 24 or në bashkëpunim me Ministrisë e Shëndetësisë – Qendrën Studentore- Karantina për cdo viktimë e cila ka qenë në nivel regional.

*Në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit-shtabit emergjent si dhe bashkësinë islame- BIK në Lipjan, çdo viktimë e dhunës në familje ka qenë përfituese e pakove ushqimore dhe higjenike të mundësuara nga dy institucionet.

*09 dhjetor 2020/ Punëtori Virtuale: Me temën Identifikimi dhe përgjigja në rastet e të mbijetuarve të Dhunës në Baza Gjinore (DhBGj) te azilkërkuesit në Kosovë: fuqizimi i bashkëpunimit të mekanizmit të referimit, përfaqësuar nga kryesuesja e këtij këshilli organizuar nga KRCT.

*Me vendim të Kryetarit, zyrtarët e Shërbimit Social nga QPS-Lipjan (4 zyrtarë) janë paisur me leje të qarkullimit të veqantë për tërë territorin e Kosovës në koordinim sa më të shpejtë dhe efikasitetë gjatë punës në teren për rastet e dhunës në familje siç vijon:

- Mbajtja e kujdestarive 24-h.
- Ofrimi i mbrojtjes- strehimit për viktimat e dhunës në baza gjinore në strehimore për gra dhe fëmijë, strehimore për mbrojtje të fëmijëve, etj;
- Bashkëpunimi ndër – institucional- Polici, Gjykatë, Prokurori, Mjeksi Ligjore, shkolla, Shëndeti mendor, Psikiatria për të rritur, psikiatri e fëmijëve, QKUK-Gjinekologji-neonatologji, pediatri, strehimore, Komuna, QPS-tjetër.

Viti 2021

*Në shtator 2021, OSBE në një punëtori 2-ditore mbështeti anëtarët e këshillit në hartimin e draft strategjisë dhe planit të veprimit për mekanizmin kundër dhunës në familje.

* Marsh në qytetin e Lipjanit ne kuadër të fushatës vetëdijesuese për dhunën në familje në sheshin “Adem Jashari”-Lipjan. Nisja nga Komuna për në Sheshin Adem Jashari-Lipjan.

* Aktivitete/sesione këshilluese në kuadër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës të mesme, Gjimnazi “Ulpiana”, Lipjan.

* Aktivitete/sesione këshilluese në kuadër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës të mesme Profesionale “Adem Gllavica” në Lipjan.

* Aktivitete/sesione këshilluese në kuadër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës filllore “Vëllëzërit Frasher” në Lipjan.

* Aktivitete/sesione këshilluese në kuadër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës filllore “Ismajl Luma” në Lipjan.

* Aktivitete/sesione këshilluese në kuadër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës së mesme mikse “Shaqir Hoxha” në fsh. Shalë.

* Aktivitete/sesione këshilluese në kuadër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës së mesme “Zenel Hajdini” në fsh. Gadime e ep.

* Aktivitete/sesione këshilluese në kuadër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore në Qendrën korrektuese edukative për të mitur QKL-Lipjan.

* Aktivitete/sesione këshilluese në kuadër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore me Qendrën korrektuese për femra QKL-Lipjan.

* Aktivitete/sesione këshilluese në kuadër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore me gratë e kskillit të bashkësisë islame (BIK).

Viti 2022

* 10.mars.2022, Takim me gratë e komunitetit RAE në fsh. Medvec, Magure, Hallaq i vogël- me temën “Rëndësija mbi shëndetin mendor” organizuar nga Ëomen's Alliance for Integration në bashkëpunim me antarët e KKMVDHFBGJ.

*20 prill.2022 Sesione informuese me gratë e komuniteteve RAE me temën “Të drejtat e grave mbi trashigiminë në pronë dhe pasurinë e përbashkët” organizuar nga Ëomen's Alliance for Integration në bashkëpunim me antarët e KKMVDHFBGJ.

*23. Maj.2022, OSBE organizoi edhe një punetori 1-ditore për të zhvilluar strategjinë dhe planin e veprimit përmekanizmin kundër dhunës në familje në komunën e Lipjanit.

* Këshilli Komunal në Mbrojtje të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Baza Gjinore, në kuadër të Komunes së Lipjanit me dt. 26.10.2022 ka mbajtur Punëtori me temën: Diskutim me Mekanizmin Koordinues-24-28 Tetor “Java e për të drejtat e viktimave të krimít, Draft Protokolli Shtetëror për trajimin e rasteve të dhunës seksuale, finalizimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit përmekanizmin kundër dhunës në familje – Komuna e Lipjanit si dhe Propozime për aktivitetet rrëth “16 Ditët e Aktivizmit” për komunën e Lipjanit.

*21.10.2022- Diskutohet për dhunën në familje dhe sfidat gjatë përballjes me këtë problem. Në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, nën organizimin e Qendrës Kosovare për Studime të

Sigurisë (QKSS) dhe në bashkëpunim me Këshilli Komunal në Mbrojtje të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Baza Gjinore, në kuadër të Komunës të Lipjanit, Zyrën për të Drejtat e Njeriut në Komunën e Lipjanit është zhvilluar projekt Gjinia, Paqja dhe Siguria.

*Takim me gratë e komunitetit RAE diskutim mbi temën “Dhuna në familje dhe baza gjinore” organizuar nga Ojq. Eomen's Alliance for Integration në bashkëpunim me antarët e KKMVDHFBGJ.

* Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës të mesme Gjimnazi “Ulpiana”, Lipjan.

*Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës të mesme Profesionale “Adem Gllavica” në Lipjan.

* Marsh për 16 ditët e aktivizimit- nisja nga Komuna e re e Lipjanit, mandej dreka nga ora 12:00 e cila është mbeshtetur për antarët e këshillit nga restaurant “7 vëllëzërit” nga asambleisti Fadil Sopa.

*Aktivitete/sesione këshilluese në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore me gratë e fshatit Janjeve, organizuar nga ojq The ideas Partnership.

* Tryezë e rrumbullakët me personat të cilët janë në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese Lipjan / Qendrën Edukativo-Korrektuese – Lipjan.

* Tryezë e rrumbullakët me gratë të cilët janë në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese për Femra – Lipjan.

*Tryezë e rrumbullakët me gratë në lokalet e bashkësisë Islame, organizuar nga BIK-Lipjan.

* Pjesemarrës antarët e këshillit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore, pjesë e panelit me temën “Procedurat e veprimit në kuadër të Shërbimeve Sociale dhe mbrojtja e viktimate në rastet e dhunës së bazuar në gjini në kontekstin e migracionit të përzier” organizuar nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) në partneritet me Zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR)/Zyra e Shefit të Misionit në Prishtinë.

Viti 2023

20.09.2023 Trajnim me antarët e KKPMDHNFDHBGJ- me temën “Të drejtat pronësore të grave si prioritet për Komunën e Lipjanit”

27.09.2023- Trajnim me të gjithë antarët e KMDHNFDHBGJ për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore –Zyra e Kryeministrat. Trajnim ky ku janë qertifikuar 36 zyrtarë komuna;

28.09.2023 Trajnim dhe qeritifikim për të gjithë antarët e Këshillit për trajnimin per Protokollin Shteteror per Trajtimin e Rasteve te Dhunes Seksuale ne Lipjan, per te cilin Kshillin per mbrojtjen per viktimat e dhunez ne familje dhe ne baza gjinore do ta mbeshtet nga Rrjeti i Grave te Kosoves ne bashkepunim me strehimoren per mbrojten e grave dhe femijeve-Prishtine QGMF.

30.11.2023- Dekorimi i sallës së Kuvendit në Komunën e Lipjanit me fjongo të siguruara nga zyra per barazi gjinore, si dhe për të gjithë asambleistët dhënia e broshurave të dhunes në familje të sigruar nga Policia Lipjan.

05.12.2023- Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës të mesme Gjimnazi “Ulpiana”, Lipjan.

05.12.2023- Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës të mesme Profesionale “Adem Gllavica” në Lipjan.

05.12.2023- Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore me gratë e fsh. Janjevë organizuar nga Ojq The ideas partnership.

06.12.2023- Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore me nxënësit e shkollës filllore “Vëllëzërit Frasher” në Lipjan.

06.12.2023- Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore menxënësit e shkollës filllore “Ismajl Luma” në Lipjan.

08.12.2023- Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore në Qendrën korrektuese edukative për të mitur QKL-Lipjan.

07.12.2023- Kryesuesja e KKMVDHNFDHBGJ ka prezantuar punën e këshillit dhe aktiviteteve të cilat jan në kuadër të komunës së Lipjan në kuadër të “Eksplorimit të Reziliencës dhe Fuqizimit të grave kundrejt dhunës në baza gjinore” I cili është mbajtur në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filozofik, organizuar nga Ëomen for Ëomen.

08.12.2023- Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore në Qendrën korrektuese edukative për të mitur QKL-Lipjan.

09.12.2023- Mirënjohje për punën e palodhshme nga Kryesuesja e Këshillit

KKMBVDHFDHBGJ dhe Kyretari I Komunës së Lipjanit për akterët e këtij këshilli të cilët kan kontribuar ndër vite.

Viti 2024

Me datat 05.06.07.03.2024 është mbajtur puntoria me kërkesë të këshillit komunal për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe baza gjinore- Qellimi i ketyre punetorive konsiston ne formimin e një grupei punues te perbere nga perfaqesuesit e institucioneve te cilat punojne ne fushen e mbrojtjes se vajzave dhe grave nga dhuna me baze gjinore. Ky grup punues duke u bazuar ne specifikat dhe sfidat e punes se perditshme, ka realizuar disa plane te mitigimit sa i perket pasojave qe ka lene pandemia COVID-19 ne komponenten e dhunes me baza gjinore ne komunen e Lipjanit. ne kuader te projektit "Se Bashku Ndertojme Reziliencen".

Me datë 25.03.2024 (e hënë) ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës, është organizuar debat i hapur publik për të diskutuar: **Projekt- Planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave (2024-2026) i Komunës së Lipjanit.** Të gjithë antaret e keshillit si dhe te tjere e kanë pasur mundësinë që edhe nëpërmjet këtij debati publik të jalin kontributin e tyre në dhënien e vërejtjeve dhe sygjerimeve në Projekt – Planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave (2024-2026).

Me dt. 08.05.2024 në Kuvendin Komunal pas prezantimit të strategjisë nga krtesuesja e këshillit Kuvendi Komunal kan aprovuar **Planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave (2024-2026) i Komunës së Lipjanit.**

Me dt. 19.09.2024 Këshilli ka mbajtur puntorinë apo takim pune për diskutimin rreth Sfidave në Procesin e Riintegrimit të Viktimate të Dhunës në Komunën e Lipjanit e mbështetur nga OSBE, ku pjesmarrës të kësaj tryze do të jenë: Anëtarët e Këshillit, Anëtarë nga Ekzekutivi Komunal etj.

Me 07.11.2024 jan trajnuar dhe qertifikuar 10 nëna vetëushqyese të cilat kan qenë viktima të dhunës ne familje, trajnim ky në kategorinë e nënave vetëushqyese, si përfituese të shërbimeve dhe trajnimeve për prindërimin e mirë që është organizuar nga OFAP në bashkëpunim me

Agjencinë për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministratit.

Me dt. 08.11.2024 Zyra për barazi gjinore në Lipjan në bashkëpunim me Organizatën CLARD dhe KADE ka organizuar trajnim njëditor me temën me antarët e KKPMDFDHEBGJ me temën

Të drejtat pronësore, procesi i regjistrimit të pronës dhe shërbimet kadastrale për motivimin e grave për regjistrimin e pronës në emër tyre ose dy bashkëshorteve.

Me datë 26.11.2024 Lansimi I spotit me temen "Ndal dhunen ne familje dhe baza gjinore".

Me datë 26.11.2024 pjesëmarrje në mediumin KTV lansimi I spotit si dhe hapja e fushatës 16 ditore për Komunën e Lipjan.

Me dt. 27.11.2024 pjesëmarje në mediumin Klan Kosova, lansimi I spotit dhe hapja e fushatës 16 ditore.

Me dt. 29.11.2024 Dekorimi I salles se kuvendit Komunal per nder te 16 ditorit kundër dhunës ne familje dhe baza gjinore.

Me dt. 03.12.2024 Takim me rininë e qytetit të Lipjanit në bibliotekën e qytetit, pjesëmarrës rreth 50 të rinjë, përfshirë shkolla Gjimnazi "Ulpiana" dhe "Adem Gllavica" mbështetur nga OSCE.

Me dt. 04.12.2024 Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore menxënësit e shkollës se mesme, Gadime e ep. Takim me nxnësit e shkollës së mesme.

Me dt. 05.12.2024 Aktivitete/sesione këshilluese në kundër dhunës në familje në kuadër të 16 ditorit të viktimate të dhunës në familje dhe baza gjinore menxënësit e shkollës së mesme në fsh. Shalë Takim me nxnësit e shkollës së mesme.

Me dt. 06.12.2024 Ojq- The ideas Partnership-Janevë Takim me gratë e lokacionit Janjevë, Organizuar nga Ojq-The Ideas Partnership.

Me dt. 09.12.2024 Qendra korrektuese dhe edukuese Lipjan Takim me grata dhe te rinjet te vendosur ne QKL

Me dt. 10.12.2024 Bashkësia Islame Lipjan-KBI Takim me gratë, organizuar nga Këshilli I Bashkësisë Islame-Departamenti i Gruas.

Gjatë këtyre viteve në secilin aktivitet të lartëcekur në pjesëmarrje për sensibilizimin kundër dhunës në familje dhe baza gjinore ishin:

6350 nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe të larta

470 mësimdhënës, drejtor dhe udhëheqës së shkollave

1550 gra nga lokaliteteve të ndryshme

I GJITHË KY PROCES PATI PJESEMARRJE AKTIVE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT SI PANELISTË PO ASHTU PJESEMARRJE EDHE NGA EKZEKUTIVI KOMUNAL, KRYETARI I KOMUNËS, NËNKRÝETARI, DREJTORËT E DREJTORATEVE, DREJTOR TË SHKOLLAVE, ASAMBLEISTË, SHOQËRIA CIVILE etj.

Të gjitha këto aktivitete janë paraparë në kuadër të takimeve të këshillit dhe me propozime nga këta antarë, çdo aktivitet i lartëcekur në secilin viti është vendosur 1 muaj më parë me propozime dhe vota në këtë këshill para se të filloj fushata vetëdijësuese e 16 ditorit të aktivizimit kundër dhunës në familje.

Trendi i rritjes së rasteve të dhunës në familje dhe baza gjinore ndërvite-

Nga viti 2016-2024

Viti 2016-17 raste të dhunës në familje

Viti 2017-14 raste të dhunës në familje

Viti 2018-33 raste të dhunës në familje

Viti 2019-42 raste të dhunës në familje

Viti 2020-54 raste të dhunës në familje

Viti 2021-79 raste të dhunës në familje

Viti 2022-75 raste të dhunës në familje

Viti 2023- 65 Raste të dhunës në familje

Viti 2024- 66 raste të dhunës në familje




Fig.1 Statistika të raportuara në takimet e këshillit.

Viktima të strehuara në strehimoren për mbrojtjen e gruas dhe fëmijëve QMGF-

Viti 2020/ 5 raste të vendosura apo 18% / Në qendrën e studentëve gjatë karantinimit 3 raste të dhunës të vendosura në kohën e pandemisë COVID19.

Viti 2021/ 16 raste të vendosura apo 57%

Viti 2022/ 7 raste të vendosura apo 25%

Viti 2023/ 11 raste të vendosura apo 43%

Viti 2024/ 9 raste të vendosura apo 40 %




Fig. 2. Statistika nga QGMF të raportuara në takimet e këshillit.

Në vitin 2024 Këshilli Komunal kundër dhunës në familje dhe baza gjinore ka bërë përpilimin e strategjisë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Lipjan (2024-2026) dhe më pas ka prezentuar në Kuvend Komunal dhe është aprovuar -

Në zhvillimin e strategjisë kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm përfaqësuesit e institucioneve lokale dhe shërbimeve regionale, duke ndihmuar që objektivat dhe masat e planifikuara të jenë të përafruara me standarde tipe normative ndërkombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është një prej dokumenteve më të rëndësishme të Komunës së Lipjanit, hartimi i së cilës ka ndjekur një proces të gjatë diskutimesh dhe kontributesh konkrete të shumë institucioneve relevante që punojnë në këtë fushë. Përfshirja dhe kontributi i tyre kanë dhënë frytin e punës që gjendet në faqet e këtij dokumenti për parandalimin e dhunës në familje në komunën tonë.

Syntezë ky që parashihet të realizohet duke adresuar me prioritet fushat e veprimit të strategjisë:

Përmirësimi i sistemit institucional për parandalim dhe ofrim të shërbimeve cilësore për mbrojtje nga dhuna në familje;

Përmirësimi i qeverisjes lokale për parandalimin dhe mbrojtje nga dhuna në familje;

Fuqizimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese të viktimateve të dhunës në familje;

Qasja strategjike e të cilit është që me anë të objektivave të qarta dhe aktivitetave specifice, të ndihmojë Mekanizmin Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në fuqizimin e tyre për përbushjen e përgjegjësive institucionale karshi institucioneve që përfaqësojnë në këtë trup institucional dhe përgjegjësive që rrjedhin nga vendimi i kryetarit për themelimin e mekanizmit (vendimi nr. 585 – 71498). Njëherit, kërkon sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore, politikave nacionale dhe standardeve ndërkombëtare për parandalimin, identifikimin pro-aktiv dhe luftimin e dhunës në familje, si dhe reagimit të menjëhershëm dhe të vazdueshëm në ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtje dhe trajtim të rasteve të dhunës në familje. Po ashtu, synon që duke marrë masa efektive në rritjen e koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve në mes të akterëve relevantë, të nxitet përparimi shoqërorë ku shoqëria është e vetëdijshme dhe mbështetëse e të drejtave të njeriut për të qenë të lirë nga të gjitha format e dhunës që promovon fuqizimin social dhe ekonomik të vajzave dhe grave dhe dhuna në familje të bëhet e papranueshme në komunitetin tonë.

Bazuar në fryshtë e Konventës së Stambollit që pranon se dhuna gjinore ndaj grave përbën “shkelje të rëndë të të drejtave të grave dhe vajzave dhe pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave”, strategjia në brendësin e saj përfshinë perspektivën gjinore duke përcaktuar masa konkrete në kuadër të planit të veprimit për fuqizimin e gruas dhe arritjen e barazisë midis burrave dhe grave.

Të bindur se investimi në kapital njerëzor nuk është vetëm gjëja e duhur për të bërë nga pikëpamja etike dhe morale, por është gjithashtu gjëja më e mençur të bëhet nga pikëpamja ekonomike për njerëzit, familjet e tyre, komunitetin, shoqërinë dhe shtetin në përgjithësi. Në këtë kuptim, strategjia adreson edhe parimet dhe dimensionet e traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht të Konventës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, si:

dinjiteti njerëzor;

barazia në mes grave dhe burrave;

mos-diskriminimi;

moskthimi;

duke kërkuar që jetesa në komunitet të zhvillohet bazuar në respektimin e shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut, të drejtave të barabarta për burra dhe gra dhe respektimin e demokracisë.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për Komunën e Lipjanit, mundëson edhe koordinimin e përpjekjeve ekzistuese të të gjitha departamenteve dhe institucioneve qeverisëse komunale dhe të organizatave joqeveritare, duke angazhuar struktura të ndryshme publike dhe private, për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet të ndryshme si ato të arsimit, shëndetit, shërbimeve sociale, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve dhe të moshuarve, etj.

Me zbatimin efikas të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje Komuna e Lipjanit do të fuqizojë dhe rrisë efikasitetin e mekanizmave institucional për mbrojtje, parandalim, ndjekje penale dhe eliminim të dhunës në familje, vetëdijesimin e shoqërisë për të sfiduar sjelljet e dhunshme duke besuar dhe mbrojtur qëndrimin se dhuna në familje kundrejt cilitdo anëtarë të saj është e pa-tolerueshme.

Rezultatet në mbështetje nga ekzekutivi komunal:

*Komuna e Lipjanit në kuadër të këshillit në bashkëpunim me stacionin Policor Lipjan, zyrën për barazi gjinore dhe për të drejtat e njeriut çdo vit, nga viti 2016-2024 në çdo fushatë sensibilizuese ka shpërndarë broshura me temën dhuna në familje si dhe numrat kontaktues për të lajmëruar rastin si dhe doracak për fëmijët mbi sigurinë me temën “Sigurtë në shkollë, në shtëpi dhe me shokë”.

Këto fletëpalosje të shpërndara në tërë teritorin e Komunës së Lipjanit kanë arritur të bëjnë sensibilizimin kundër dhunës në familje. Numri i fletëpalosjeve arrin mbi 10 mijë broshura nga stacioni policor Lipjan të shpërndara në kampanja dhe fushata vetedijësuese kundër dhunës në familje, ndërsa zyra për barazi gjinore dhe për të drejtat e njeriut ka shpërndarë mbi 4 mijë broshura të shpërndara në kampanja dhe fushata vetedijësuese kundër dhunës në familje.

*Nënshkrimi i marrëveshjes nga Fondacioni “OPERACIONI I MËKËMBJES” lidhur me rehabilitim dhe ri-integrim të viktimate të dhunës në familje nënshkruar nga Kryetari më 01.09.2016.

*Bazuar vendimin për ndarjen e banesave në pronësi të Komunës konform dispozitave të Ligjit për financimin e Programeve të veçanta të banimit sipas vendimit të Kuvendit të Komunës, dy banesa janë ndarë dhe kan përfituar dy nëna vetëushqyese të cilat kan qenë raste të dhunës në familje, duke i plotësuar të gjitha kriteret për përfitim, njëra nga përfitueset ka qenë nga komuniteti RAE dhe njëra shqipëtare, të cilat kan ndihmuar në procesin e rimëkëmbjes së këtyre të mbijetuarave dhe riintegrimin e tyre.

*Nga viti 2020/2021/e në vitin 2022 gjatë periudhës tre vjeçare 2023, 2024 dhe 2025 është nënshkruar Memorandum i Mirëkuptimit në mes Komunës së Lipjanit dhe Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve ku ndihmohet nga Komuna e Lipjanit.

*Komuna e Lipjanit dhe Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (QMFG) në Prishtinë, ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit, për mbështetje të shpenzimeve për strehimoren e kësaj qendre në Prishtinë për gjatë periudhës tre vjeçare 2020, 2021, 2022, 2023, 2024 dhe 2025.

*Komuna e Lipjanit ne vitin 2020 ka ndarë mjete për strehimoren në vlerë 3.000 €, në vitin 2021 ka ndarë mjete për strehimorën në vlerë 2.832.27 €, e në marëveshjen e mirëkuptimit në 2022-2025, Komuna e Lipjanit qdo vitë në vlerë prej 3.332.60 € do e mbështes këtë qendër e cila mundëson trajtimin dhe mbrojtjen e viktimate të dhunës familjare dhe gjinore, fëmijëve dhe grave.

*Këshilli Komunal në Mbrojtje të Viktimate të Dhunës në Familje dhe Baza Gjinore, në kuadër të Komunes së Lipjanit në bashkëpunim me entin e punsimit ka siguruar punë për viktimat e dhunës në familje dhe në baza gjinore në numër të konsiderueshëm me masën 1.8, ku secila viktimë është njoftuar.

* Komuna e Lipjanit ka hartuar dhe aprovuar në Kuvendin Komunal Strategjinë mbi përfshirjen sociale 2022-2024. Vendimi me Nr. 15-550/01-34127 i dt. 29.06.2022. Në kuadër të kësaj strategjije janë paraparë edhe aktivitetet ku do të ndihmojnë fuqizimin e KKVDHFBGJ.

Target grupi në këtë projekt të përfshirë në strategjinë komunale do të jenë prindër nga komunitetet jo shumicë duke përfshirë edhe shqiptarët të cilët janë prindër më fëmijë më nevoja të veqanta , prindër që kanë fëmijë për edukim të hershëm në komunën e Lipjanit si dhe vetëdijesimin mbi dhunën në familje, këto sesione këshilluese do të mbahen në 6 lokacone si: Lipjan (qytet), Medvec, Magure, Hallaq, Janjevë dhe Gadime në periudhën kohore dhjetor 2022- shkurt 2023.

Me dt. 08.05.2024 në Kuvendin Komunal është aprovuar Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave (2024-2026) i Komunës së Lipjanit.

Me dt. 19.09.2024 Këshilli ka mbajtur puntorinë apo takim pune për diskutimin rreth Sfidave në Procesin e Riintegrimit të Viktimate të Dhunës në Komunën e Lipjanit e mbështetur nga OSBE, ku pjesmarrës të kësaj tryze do të jenë: Anëtarët e Këshillit, Anëtarë nga Ekzekutivi Komunal etj, ku është propozuar dhe aprovuar që viktimat e dhunës në familje të mbështeten me qiradhënie përviktimen dhe fëmijët në kohë prej 6+6 muaj varësishtë vlerësimit nga puntori social, kjo këkesë është aprovuar nga Kryetari dhe aprovuar dhe punuar edhe nga Zyra Ligjore me kërkesa tek Këshilli drejtuar Drejtoratit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale e më pas kërkesa tek Kryetari Komunës.

Rekomandimet nga ana e këshillit të adresuara për ekzekutivin:

- Mështetja e viktimave të dhunës me një fond emergjent të mbuluar me vendim dhe votuar nga Antarët e Kuvendit Komunal-Lipjan.

Plani i monitorimit dhe raportimit

- Synimi kryesorë i Komunës së Lipjanit pa dyshim se është realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite.
- Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Plan të Veprimit.
- Për ta vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve, apo anasjelltas, Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje do të raportojnë përparimin në jetësimin e zbatimit e planit në baza vjetore.
- Kryesuesja e këshillit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinoree do të ketë rolin udhëheqës për të bashkërenduar punën, mbikëqyrur dhe vlerësuar procesin e zbatimit të Planit të Veprimit, në të njëjtën kohë do të shërbejë si Sekretariat, dhe në baza periodike çdo vit/6 muaj do ti raportojë direkt Kryetarit të Komunës.
- Me ç ‘rast, çdo fund vit Mekanizmi Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është i obliguar të hartojnë “Raportin e Monitorimit” mbi zbatimin, i cili do të jetë treguesi kyçë për të pasqyruar qartë progresin apo regresin mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të parapara në Planin e Veprimit.

Raportuar nga Fjolla Ibrahim Starabaja,
Kryesuese e Këshillit MVDHFBGJ.

Më 09.12.2024